# REPUBLIKA E KOSOVËS
## REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
## KOMUNA E DRAGASHIT
## DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 10.06.2025 |
| **Referencë:** | |
| **Për:** | z. Muhidin Emini – Koordinator për Performancë Komunale |
| **Kopje:** | z.Resul Fetahu – U.D. i drejtorit të Administratës |
| **Nga:** | Ellmedina Neziri, Zyra për Marrëdhënie me Publikun<br>Fari Kolloni, zyrtar për Informim |
| **Lënda:** | Raport për përmbushjen e kritereve të faqes zyrtare elektronike të Komunës së Dragashit |

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra për Marrëdhënie me Publikun e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Dragashit, në bashkëpunim me zyrtarin për Informim dhe Zyrën e IT-së, gjatë vitit 2024 ka realizuar një sërë aktivitetesh të rëndësishme të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të transparencës ndaj qytetarëve. Gjatë fundit të vitit 2024 dhe fillimit të vitit 2025 është bërë edhe lansimi gradual i uebfaqeve të reja të komunave, gjë e cila ka shkaktuar një sërë sfidash lidhur me publikimin e të dhënave. Megjithatë, zyrtarët përgjegjës komunalë për mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave në uebfaqeve kanë realizuar me sukses të gjitha detyrat.

Gjatë gjithë periudhës raportuese, në vazhdimësi jemi përpjekur që të respektojmë dygjuhësinë, duke publikuar të gjitha aktivitetet e kryetarit të Komunës dhe organeve të tjera të institucionit, si dhe shumicën e dokumenteve dhe akteve administrative në të dy gjuhët zyrtare, shqip dhe boshnjakisht. Në bashkëpunim me Zyrën e Kuvendit dhe të IT-së, gjithashtu është bërë edhe publikimi i të gjitha materialeve lidhur me seancat e Kuvendit të Komunës së Dragashit dhe komiteteve përkatëse, duke përfshirë ftesat për seancë, procesverbalet dhe lajmet për mbajtjen e mbledhjeve.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
05 Nr. Br. 052/05-11158/25
10.06.2025
Dragash - Dragaš

Në fushën e konsultimeve publike me qytetarët për hartimin e dokumenteve të ndryshme, si dhe atë të dëgjimeve buxhetore për hartimin e dokumenteve buxhetore të Komunës, janë të krijuara rubrikat e veçanta ku bëhet publikimi i të gjitha njoftimeve për dëgjime buxhetore dhe konsultime publike me qytetarë, draft-dokumenteve për konsultim me publikun, si dhe procesverbaleve dhe raporteve për ecurinë e përgjithshme të konsultimeve publike, takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore. Kjo do të ndikojë në masë të madhe në rritjen e transparencës dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve dhe organizatave të ndryshme në këto dokumente.

Zyrtarja për Marrëdhënie me Publikun dhe zyrtari për Informim kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet dhe takimet zyrtare të kryetarit të Komunës, si dhe në aktivitetet dhe organizimet e zhvilluara nga Kuvendi i Komunës dhe organet tjera të Administratës komunale dhe stafit politik. Për këto aktivitete janë publikuar në vazhdimësi lajme dhe informacione në të dy gjuhët zyrtare në uebfaqen zyrtare dhe Facebook. Gjithashtu, në bashkëpunim me drejtoritë dhe zyrtarët përkatës komunalë, janë publikuar lajme, njoftime, konkurse, thirrje publike, procesverbale, raporte dhe dokumente të ndryshme publike me interes të përgjithshëm, çdo herë sipas kritereve të parapara ligjore.

## TË DHËNAT TABELARE

**NUMRI I DOKUMENTEVE TË PUBLIKUARA NË UEBFAQE GJATË VITIT 2024 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2023**

**1. KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: KRYETARI DHE DREJTORET**

| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Vendimet e kryetarit* | 13 | 12 | 1 |
| 2 | Raporti Vjetor dhe Plani Vjetor i Punës të Kryetarit | 1 | 1 | 0 |
| 3 | Raportet vjetore të punës të drejtorëve | 8 | 8 | 0 |
| 4 | Planet vjetore të punës të drejtorëve | 8 | 8 | 0 |
| 5 | Raporti Vjetor për Qasje në Dokumente Publike | 1 | 1 | 0 |

*Shënim: Numri i vendimeve të kryetarit i dhënë në tabelën më lart është për shkak se vendimet janë publikuar për çdo muaj të integruara brenda një fajlli (dokumenti)

Numri total i vendimeve të Kryetarit të publikuara për vitin 2024 është: 504

Numri total i vendimeve të Kryetarit të publikuara për vitin 2023 është: 571

3). KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: KUVENDI

| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Rregulloret | 1 | 1 | 0 |
| 2 | Vendimet e Kuvendit | 42 | 16 | 26 |
| 3 | Video-seancat e mbledhjeve të Kuvendit | 6 | 13 | -7 |
| 4 | Thirrjet për mbledhjet e Kuvendit | 11 | 13 | -2 |
| 5 | Thirrjet për mbledhjet e KPF-së | 10 | 8 | 2 |
| 6 | Thirrjet për mbledhjet e Komitetit për Komunitete | 10 | 8 | 2 |
| 7 | Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit | 12 | 13 | 1 |
| 8 | Procesverbalet e mbledhjeve të KPF-së | 6 | 7 | -1 |
| 9 | Procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete | 7 | 7 | 0 |

4). KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: SHPALLJET

| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Dokumente për Aplikacione | 1 | 6 | -5 |
| 2 | Dokumente për Konkurse | 39 | 15 | 24 |
| 3 | Njoftime të ndryshme | 10 | 33 | -23 |
| 4 | Dokumente për pronat komunale | 12 | 3 | 9 |
| 5 | Thiirrje për propozime | 14 | 2 | 12 |

5). KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: PROKURIMI

| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Ftesë për ofertim për shitje të aseteve | 0 | 19 | -19 |
| 2 | Kërkesat për rishqyrtim dhe vendimet e Komunës | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Kontratat e nënshkruara | 122 | 159 | -37 |
| 4 | Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit | 11 | 37 | -26 |
| 5 | Njoftim për dhënie të kontratës | 96 | 129 | -33 |
| 6 | Njoftim për informata shtesë | 8 | 2 | 6 |
| 7 | Njoftim për kontratë | 106 | 146 | -40 |
| 8 | Njoftim për nënshkrim të kontratës | 115 | 151 | -36 |
| 9 | Plani i Prokurimit për vitin 2024 | 1 | 1 | 0 |
| 10 | Raporti i Kontratave të Nënshkruara 2023 | 1 | 1 | 0 |
| 11 | Vendim për ndërprerje të kontratës | 0 | 0 | 0 |

Organogrami i Komunës së Dragashit



Organogrami i Komunës së Dragashit i publikuar në uebfaqen zyrtare

| V. KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: FINANCAT | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Buxheti (Qarkoret buxhetore, KAB, Buxheti Gjinor etj.) | 12 | 8 | 4 |
| 2 | Raportet tremujore financiare | 2 | 0 | 2 |
| 3 | Raportet periodike financiare | 5 | 6 | -1 |
| 4 | Raportet vjetore (Raporti i Auditimit, pasqyrat financiare etj.) | 6 | 3 | 6 |
| 5 | Shpenzimet Kapitale | 1 | 1 | 0 |

| VI. KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: KONSULTIMET, TAKIMET DHE DËGJIMET PUBLIKE/BUXHETORE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Njoftimet për konsultim publik | 5 | 5 | 0 |
| 2 | Dokumentet në konsultim publik | 3 | 6 | -3 |
| 3 | Njoftimet për takime publike dhe dëgjime buxhetore | 14 | 12 | 2 |
| 4 | Draft-buxheti për konsultim publik | 2 | 4 | -2 |
| 5 | Procesverbalet dhe raportet | 24 | 20 | 2 |

| VII. KATEGORIA E BALLINËS NË UEBFAQE: LAJMET | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përshkrimi dokumentit | Numri i publikimeve | | Diferenca |
| | | Viti 2024 | Viti 2023 | |
| 1 | Lajmet për aktivitetet e kryetarit, qeverisjes lokale, Kuvendit të Komunës, si dhe informacione për aktivitete të tjera të institucionit | 142 | 110 | 32 |

| TË DHËNAT E PËRGJITHSHME | VITI 2024 | VITI 2023 | DIFERENCA |
|---|---|---|---|
| Numri i dokumenteve të publikuara | **746** | **855** | **-109** |
| Numri i lajmeve të publikuara | **142** | **110** | **32** |